

KONTRATE DHURIMI PASURI E LUAJTSHME
(Lloji kuota)

Sot me date **14/04/2022**, palet e meposhtme neshkruaje kete kontrate si me poshte vijon:

DHURUESI : "**DENTAL CARE**", **shpk**, me numer nipti L82817205A, te ndodhur ne Elbasan perfaqesuar nga Administrator I saj: **JETI KURTI** i datelindjes 27/06/1988, lindur dhe banues ne Elbasan, I identifikuar me leternjoftimin numer 036262852, numer personal I85627079B, leshuar me date 29/07/2020, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar. (**Ketu e me poshte i quajtur dhuruesi i pasurise**).

PRANUESI I DHURIMIT

MADIELO GEGA i biri i Maksim i datelindjes 10/08/1983, lindur ne Elbasan dhe banues ne Lagjen Kongresi i Elbasanit, Elbasan, mbajtes i numer personal I30810077G, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar me **poshte i quajtur "PRANUESI I DHURIMIT"**

Dhuruesi dhe pranuesi i dhurimit, referuar të dy së bashku do të quhen "Palët".

Të përgjithshme

1. Pala dhuruese ZNJ. JETI KURTI me cilesine e administratorit dhe ortakut te vetem te shoqerise "**DENTAL CARE**" **shpk.**, e cila eshte pronare me 100 % te kuotave te kapitalit të Shoqërisë, 1 pjese, 1 kuote edhe kerkon t'i dhuroje Z. MADIELO GEGA **50** % te vleres se kapitalit ne shumen 50.000,00 lekë.
2. Shoqëria është rregjistruar pranë QKB-se si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, **me numer nipti** L82817205A, me objekt "Sherbime dentare. Investime me qellim zhvillimin, ndertimin, administrimin dhe shitjen e nje godine multifunkionale, banimi dhe sherbimesh si nje projekt i shoqerise. Ndertime urbane dhe civile te ndryshme, punime ndertimi civile te ndryshme, restaurime, etj. Dhuruesi qe zoteron 100% te kuotave ne kete shoqeri, dëshiron t'i dhuroje 50 % të kuotave z. Madielo Gega, dhe pranuesi i dhurimit z. Madielo Gega, dëshiron të pranoje sipas kushteve të kësaj kontrate dhe pas kalimit të kuotave bëhen bashkepronare te dy, me nga 50% secili, ortak se bashku te 100 % te kuotave te shoqërisë "**DENTAL CARE**" **shpk.**, pra jane zoterues te dy te 100 %, te kapitalit te Shoqerise "**DENTAL CARE**" **shpk"**, pra 1 pjese dhe 1 kuote per secilin ortak.
3. Në përputhje me nenin 117 pika b "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", të Ligjit Nr.9901, date 14.04.2008 «Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare », neni 761 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e dhurimit ", dhe në përgjithësi të legjislacionit shqiptar në fuqi, hartohet kontrata e dhurimit së kuotave si më poshtë vijon:
4. Dhuruesi dëshiron t'i dhuroje pranuesit te dhurimit 50 % te kuotave te shoqerise, dhe behet edhe ortak i shoqerise, i cili behet bashkepronar me 50 % te kuotave, ne kete shoqeri me 50 % te kuotave.
5. Në përputhje me "Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave", sipas Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare » i ndryshuar, Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë "Dispozitat e Përgjithshme për kontratën e dhurimit", hartohet kontrata e dhurimit si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

- 1.1 Në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në këtë kontrate, dhuruesi i kalon 50 % te kuotave ,nga kapitali i zotëruar në shoqëri si dhe të drejtën e pronësisë mbi kuotat dhe të drejtat e tjera të lidhura me këtë pjesëmarrje pranuesit te dhurimit duke e

garantuar plotësisht titullin e pronësisë të pa rënduar me barrë dhe pranuesi i dhurimit nga ana tjetër pranon nga dhuruesi kuotat pa kundershperblim.

Neni 2

Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat

2.1 Kalimi i pronësisë së ligjshme mbi kuotat nga dhuruesi te pranuesit do të kryhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës dhe depozitim të kontratës në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

Neni 3

Garancitë

Dhuruesi në lidhje me kuotat që zotëron, garanton pranuesit e dhurimit:

1. Se është pronar me 100% të kuotave të dhuruara e nuk ekzistojnë të drejta të parablerjes, të blerjes, të marrjes ose të opsionit të ndonjë personi të tretë në lidhje me kuotat e dhuruara.
2. Se e drejta për përfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara në shoqërinë do të mund të ushtrohet rregullisht.
3. Shoqëria nuk është pjesëmarrëse direkte ose indirekte në shoqëri të tjera dhe as nuk është e detyruar të blejë apo të mbajë pjesëmarrje të tilla.
4. Të gjitha të mirat ekonomike të përdorura nga shoqëria, të cilat janë të nevojshme ose të dobishme për aktivitetin ekonomik të shoqërisë dhe për vazhdimin e pakufizuar të tyre pas ditës së lidhjes së Kontratës së dhurimit të Kuotave, veçanërisht objektet pasurore janë në pronën e vetme e shoqërisë dhe nuk janë ngarkuar me të drejta ose pretendime të të tretëve.

Neni 4

Regjistrimi

Regjistrimi i kalimit edhe dhurimit të kuotes do të kryhet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 5

Ligji i zbatueshëm

Kjo kontratë rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" si dhe dispozitat e aktit të themelimit dhe Statutit të Shoqërisë.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët do të përpiqen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate, në të kundërt kompetentepërzgjidhjen e konfliktit do të jete Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Neni 7

Tëndryshme

Kontrata u hartua në 4 (kater) kopje me tenjejtenuqilgjore.

PALET KONTRAKTUESE

DHURUESI



PRANUESI